



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare
www.qbz.gov.al

Nr. 76

10 maj

2013

PËRMBAJTJA

Faqe

Ligj nr. 124/2013 datë 25.4.2013	Për një shtesë në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Përtatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar	3271
Ligj nr. 125/2013 datë 25.4.2013	Për koncesionet dhe partneritetin publik privat.....	3271
Ligj nr. 126/2013 datë 25.4.2013	Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 10 383, datë 24.2.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë"	3293
Vendim i Kuvendit nr. 35/2013, datë 2.5.2013	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.....	3294
Vendim i Kuvendit nr. 36/2013, datë 2.5.2013	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.....	3294
Vendim i Kuvendit nr. 37/2013, datë 2.5.2013	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.....	3295
Vendim i Kuvendit nr. 38/2013, datë 2.5.2013	Për caktimin e kryetarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.....	3296
Vendim i Kuvendit nr. 39/2013, datë 2.5.2013	Për mbylljen e legjislaturës VII të Kuvendit të Shqipërisë.....	3296
Rezolutë e Kuvendit datë 2.5.2013	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës përvitin 2012.....	3297
Rezolutë e Kuvendit datë 2.5.2013	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) përvitin 2012.....	3298

Rezolutë e Kuvendit
datë 2.5.2013

Rezolutë e Kuvendit
datë 2.5.2013

Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregulator të Energjisë (ERE) për vitin 2012.....	3300
Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për vitin 2012.....	3302



REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË (ERE) PËR VITIN 2012

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke pasur parasysh rolin e Entit Rregulator të Energjisë, si autoriteti i vetëm dhe i pavarur rregulator për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike dhe të gazit natyror në vend;
 - Duke njohur arritjen tashmë disavjeçare të Qeverisë për furnizimin pa ndërprerje të konsumatorëve me energji elektrike;
 - Duke parë se përpjekjet e Entit Rregulator të Energjisë u fokusuan në drejtim të kontrollit të shërbimeve të ofruara në tregun e energjisë elektrike, cilësisë së tyre dhe mbrojtjes së konsumatorit;
 - Duke vlerësuar transparencën e ERE-s ndaj publikut, përmes konsultimeve dhe komunikimit me të gjitha palët e interesuara, si dhe me publikun e gjere;
 - Duke pasur parasysh se të gjitha vendimmarjet e ERE-s kanë synuar të stimulojnë investimet në segmente kyç të sektorit, të cilat ndikojnë në përmirësimin e kaskadës, në fuqizimin e rrjetit të transmetimit dhe atij të shpërndarjes, duke orientuar investimet në shpërndarje, në funksion të uljes së humbjeve në sistemin e shpërndarjes;
 - Duke konsideruar rëndësinë që ka liberalizimi i tregut të furnizimit me pakicë të energjisë elektrike;
 - Duke pasur parasysh se situata e sektorit të energjisë elektrike, në drejtim të realizimit të investimeve dhe gjendjes financiare të pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, ka qenë e vështirë, si pasojë e problematikave të vërejtura nga sjellja në treg e operatorit të sistemit të shpërndarjes;
 - Duke vlerësuar si shumë të rëndësishme punën për realizimin e mundësisë së furnizimit të vendit me gaz natyror, nëpërmjet alternativave më të favorshme dhe për përgatitjen e kuadrit rregulator në këtë fushë;
 - Duke pasur parasysh punën intensive që është bërë në drejtim të diversifikimit të furnizimit me energji në vend;
 - Duke vlerësuar arritjet dhe hapat përpara në tregun e energjisë elektrike, në kuadër të miratimit nga ERE të rregullave të balancimit të energjisë elektrike dhe ankandit të kapaciteteve të interkoneksionit;
 - Duke vlerësuar si përparësi kombëtare lidhjen e rrjetit energetik shqiptar, nëpërmjet linjave të interkoneksionit 400 kw, me rrjetin energetik ballkanik dhe tregun europian të energjisë;
- Konstaton se ERE në vitin 2012:**
- Ka shqyrtuar aplikimet për përditësimin e tarifave të të licencuarve në sektorin elektroenergetik, përfshirë veprimtaritë e prodhimit, furnizimit publik me shumicë, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike për klientët tariforë.
 - Ka kryer një veprimtari të gjërë për licencimin e subjekteve në veprimtaritë e ndryshme të sektorit të energjisë elektrike, si dhe atë të gazit natyror.
 - Ka miratuar udhëzuesit për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në Projektin Trans Adriatik Pipeline (TAP), një dokument me mjaft rëndësi, në kuadër të mbështetjes së projektit TAP AG, duke e fokusuar vëmendjen kryesore në mbështetjen e gjithanshme të përpjekjeve për konkretizimin e projektit TAP, për të krijuar hapësirat e nevojshme për interesat shqiptarë në të.
 - Ka ushtruar monitorime për të kontrolluar dhe inspektuar shërbimet e rregulluara të operatoreve të licencuar në sektorin e energjisë elektrike, në lidhje me mirëfunksionimin e tregut të energjisë elektrike, eficencës dhe cilësisë së shërbimit që ata ofrojnë për konsumatorët, në përputhje me autoritetin e dhënë sipas ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të 3300

ndryshuar.

- Ka garantuar mbrojtjen e vazhdueshme të interesave dhe të drejtave të konsumatorëve tariforë, nëpërmjet trajtimit me përkushtim, transparencë, paanshmëri dhe brenda afateve ligjore të ankesave të konsumatorëve.

- Ka punuar në zhvillimin e kapaciteteve të veta institucionale për krijimin e kuadrit të domosdoshëm rregullator në fushën e gazit natyror, të harmonizuar me direktivat e BE-së dhe me vendet e rajonit.

- Ka realizuar metodologjitet përkatëse për miratimin e tarifave dhe studimeve të miratuara, sipas Deklaratës Rregullatore, përditësimin e tarifave dhe akomodimin e kostove të shërbimeve, si në veprimtarinë e prodhimit, furnizimit publik me shumicë dhe furnizimit publik me pakicë, duke pasur parasysh parimin për sigurimin e energjisë elektrike për konsumatorët, në përputhje me kostot më të ulëta dhe të arsyeshme.

- ERE ka orientuar punën e tij në drejtim të vendosjes së një bashkëpunimi me operatorët e tregut në sektorin e energjisë elektrike, nëpërmjet organizimit të takimeve periodike me ta.

- Në kuadër të një analize të kujdeshsime dhe në konsultë edhe me institucionet e tjera përgjegjëse të sektorit të energjisë elektrike, por edhe me institucionet ndërkombëtare që mbikëqyrin këtë sektor, një nga vendimarrjet më të rëndësishme të ERE-s ishte procedimi administrativ ndaj CEZ Shpërndarjes për heqjen e licencave në veprimtarinë e shpërndarjes dhe furnizuesit publik me pakicë.

- ERE ka vazduar fuqizimin e kapaciteteve të veta institucionale për hartimin e kuadrit rregullator në fushën e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, për ta harmonizuar atë me direktivat e BE-së dhe detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

- Me qëllim rritjen e sigurisë së furnizimit në vend dhe në kuadër të një klime promovuese për investimet e reja, ka licencuar 49 subjekte juridike në prodhim energjie, tregtues energjie, furnizues të kualifikuar të energjisë elektrike, si dhe modifikime të licencave ekzistuese, ndërsa 11 aplikime janë në proces shqyrtimi.

- Ka konsoliduar akoma më shumë marrëdhëni me Kuvendin e Shqipërisë dhe institucionet e tjera shtetërore dhe ka vazduar të ndjekë një formë bashkëpunimi dhe informimi periodik për zgjidhjen e sfidave të ndeshura në procesin e rregullimit të sektorit të energjisë elektrike.

Kërkon që ERE për vitin 2013:

Në përputhje me autoritetin dhe përgjegjësitë, në mënyrë të veçantë në kushtet e administrimit të përkohshëm të kompanisë së shpërndarjes, të fokusojë të gjitha përpjekjet në rivendosjen e një tregu funksional të bazuar në respektimin e marrëveshjeve dypalëshe, eficencës së energjisë elektrike, normalizimit të veprimtarisë së shpërndarjes dhe garantimit të furnizimit të pandërpërre të konsumatorëve.

Të intensifikojë më tej punën për monitorimin, në mënyrë të veçantë të kompanisë CEZ Shpërndarje, për përmirësimin e treguesve kryesorë të saj në drejtim të humbjeve në rrjet dhe rritjes së arkëtimeve.

Në analizë të problematikës së lindur nga mosmarrëveshjet me CEZ Shpërndarjen dhe në përputhje me kapacitetet institucionale dhe përgjegjësitet ligjore, të sigurojë mbështetje për institucionet përgjegjëse në mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar në procedimet administrative apo gjyqësore që kanë lidhje me këtë konflikt.

Të vazhdojë veprimtaria në monitorimin e tregut të energjisë elektrike për të rritur transparencën dhe garantuar mosdiskriminimin, nëpërmjet procesit të hartimit të rregullave dhe rregulloreve, për të nxitur konkurrencën në këtë treg dhe orientimin e tij drejt liberalizimit dhe rritjes së konkurrencës në ankandet e allokimit të kapaciteteve të interkoneksionit.



Të rishikojë Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike, Rregullat e Alokimit të Kapaciteteve, Marrëveshjen e Shërbimit të Transmetimit, me qëllim harmonizimin me kushtet e reja të hapjes së tregut dhe përshtatjes së tij me tregun rajonal, nën fryshten e përafrimit të legjislacionit me Paketën e Tretë Rregullatore të Bashkimit Europian.

Të vijojë punën në plotësimin e kuadrit rregulator dhe kryerjen e procedurave të nevojshme përmes mbështetjen e projekteve me interes kombëtar për gazifikimin e vendit.

Të vazhdojë të garantojë mbrojtjen e konsumatoreve të energjisë elektrike, nëpërmjet trajtimit me përkushtim të ankesave të konsumatorëve, në përputhje me Kontratën e Furnizimit dhe Standardet e Trajimit dhe Zgjidhjes së Ankesave të Konsumatorëve nga ana e të licencuarve, brenda kushteve dhe afateve të përcaktuara në këto akte.

Të monitorojë cilësinë e shërbimit të ofruar konsumatorëve, përmes garantuar furnizim të pandërrerë me energji elektrike në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, në përputhje me standartet minimale të cilësisë së shërbimit të energjisë, të miratuara nga ERE.

Të inkurajojë realizimin e projekteve publike apo private përmes lidhjen e rrjetit energetik shqiptar me rrjetin rajonal.

Miratuar në datën 2.5.2013

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE
TELEVIZIONIT PËR VITIN 2012

Kuvendi i Shqipërisë vëren se:

- KKRT-ja ka arritur të dukshme në zbatimin e kërkesave të Kuvendit të shprehura në rezolutën e vlerësimit të punës së këtij institucioni përmes vitit 2011.
- Veprimtaria e KKRT-së është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Kuvendi vlerëson se:

- KKRT-ja gjatë vitit 2012 ka bërë përpjekje maksimale përmes realizimin e objektivave që lidhen me zbatimin e kuadrit ligjor dhe ecurinë e institucionit. Vlerësimi të veçantë meriton ky institucion përmes kontributin e dhënës së hartimin e "Strategjisë së kalimit nga sistemi i transmetimit analog në atë numerik", si dhe ndihmesën teknike në procesin e hartimit të projektligjit "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

- Vendimet dhe aktet e marra nga KKRT-ja kanë përmirësuar ndjeshëm peizazhin audiovizual.

- Në sajë të punës së KKRT-së, tek operatorët radiotelevizivë është vënë re një rritje e ndërgjegjësimit, lidhur me detyrimet që ata kanë përmes respektimin e të drejtave të autorit. Shumë operatorë kanë depozituar në KKRT autorizimet me katër agjenci të administrimit kolektiv: AMP, AKDIE, ALBAUTOR, FMAA, si edhe vërtetimin nga Zyra Shqiptare përmes Drejtat e Autorit.

- KKRT-ja ka vazhduar të monitorojë kohën e vënë në dispozicion të subjekteve politike nga operatorët radiotelevizivë në edicionet informative, zbatimin e kërkesave ligjore përmes transmetimit e reklamave, të programacionit etj., duke u treguar korrekte, e paanshme dhe zbatuese e ligjit.

- Si rrjedhojë e kërkesave të vazhdueshme të KKRT-së, ka një rritje të ndjenjës së përgjegjësisë ndaj llojshmërisë dhe larmisë së programeve, ndaj cilësisë, si edhe përbajtjes së tyre.